

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr.2004/09

Prishtinë,më 27 maj 2004, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Bajram **Kosumi**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 79 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit të sesionit të mëparshëm;
2. Shqyrtimi i raportit të Grupit të Punës për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për ndërtimet, nr.2004/13;
4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për ndërmarrjet, nr.2004/4;
5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për veprimtaritë hoteliere dhe turistike, nr.2004/3;
6. Amendamenti i Ligjit për produktet dhe pajisjet medicinale, 2003/26;
7. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr.2004/16;
8. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për tregtinë e brendshme, 2004/18;
9. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për koncesione, nr.2004/19;
10. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për gatishmërinë emergjente civile, nr.2004/15;
11. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për veterinarinë, nr.2004/14;
12. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për tatimin në të ardhurat personale, 2004/17;
13. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të buxhetit të Kosovës për vitin 2003 dhe
14. Shqyrtimi i raportit të buxhetit për tre mujorin e parë të vitit 2004.

Kryetari propozoi që pikat 6, 13 dhe 14 të hiqen nga rendi i ditës – ngase nuk ishin bërë përgatitjet e nevojshme për shqyrtimin e tyre.

Haki Shatri tha se kërkesa e Komisionit për Buxhet ka qenë që në seancën e sotme të shqyrtohet raporti përfundimtar i Buxhetit të Kosovës për vitin 2003, ngase në bazë të dispozitave të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësive, ai duhet të shqyrtohet menjëherë porsa të ketë kaluar marsi, gjegjësisht gjatë muajit prill.

Ministri Ali Sadriu tha se në Ligjin për menaxhimin e financave publike parashihet që raporti përfundimtar i buxhetit dërgohet përmes librit të buxhetit dhe koha e raportimit të tij është deri më 30 qershor, kurse më 30 mars mbyllet librat. Periudha nga 31 mars deri 31 qershor është periudhë e përgatitjes së të gjitha atyre transaksioneve.

Berat Luzha tha se kthimi i martirëve shqiptar, të kidnapuar, të ekzekutuar dhe pastaj të hudhur nëpër varreza masive në Serbi, në grupe të ndara, po shkakton pezmadhësi dhe revoltë të arsyeshme në opinionin tonë dhe veçanërisht te familjarët dhe te shoqarat e tyre. Shoqatat e familjarëve janë në shqyrtim të vendimit që të mos i marrin nga murgu i Rahovecit kufomat e martirëve - si reagim dhe protestë për shkak të kthimit të tyre në grupe, si dhe për shkak të pakënaqësisë së tyre me punën e institucioneve vendore me këtë.

Ai propozoi të radhitet në rendin e ditës të seancës së sotme, si çështje e ngutshme – kthimi i menjëhershëm dhe i të gjitha kufomave të martirëve shqiptar, që janë në varrezat masive në Serbi.

Kryetari tha se i përkrah shqetësimet që ingriti deputeti Berat Luzha, por për ta radhitur këtë çështje në rend dite të seancës plenare, paraprakisht duhet që Komisioni përkatës i Kuvendit dhe ai i Qeverisë ta shqyrtojnë këtë çështje dhe t’ia propozojnë Kuvendit qëndrimet dhe rekomandimet për shqyrtim dhe miratim.

Me kërkesën e kryetarit u hoqën nga rendi i ditës pikat e 6, 13 dhe 14, të propozuara nga Kryesia për këtë seancë.

1. Miratimi i procesverbalit të sesionit të mëparshëm

Procesverbali i sesionit të mëparshëm u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i raportit të Grupit të punës për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese

Kryetari e ftoi Arsim Bajramin ta arsyetonte raportin e Grupit të Punës për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese.

Arsim Bajrami, në emër të Grupit të Punës të hartimit të amendamenteve për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese, tha se i kanë mbajtur mbi dhjetë takime, kanë mbajtur një dëgjim publik dhe kanë bashkëpunuar edhe me Zyrën Ligjore të UNMIK-ut. Qëllimi i parë i ndryshimeve të prezentuara është plotësimi i difekteve që i kishte Korniza kushtetuese edhe në momentin e fillimit.

Qëllimi i dytë është krijimi i bazës së re konstitucionale – për bartjen e përgjegjësive tek institucionet vendore.

Qëllimi i tretë është krijimi i parakushteve ligjore dhe konstitucionale për përmbushjen e standardeve për Kosovën.

Ne mendojmë se projekti “Standardet për Kosovën” kërkon kompetenca të reja për organet e Kosovës, në mënyrë që të arrihen përparime të dëshiruara në këtë fushë.

Dhe, qëllimi i fundit, është në fakt progresi në realizimin e misionit të Kombeve të Bashkuara dhe përgatitja e zgjidhjes finale për statusin e Kosovës.

Baza kushtetuese për ta ndryshuar Kornizën Kushtetuese është përcaktuar shprehimisht në Kreun 14 pika 3, e cila parasheh të drejtën e Kuvendit të Kosovës që me një shumicë prej dy të tretave të kërkojë ndryshime adekuate në Kornizën kushtetuese.

Komisioni mendon se Korniza Kushtetuese duhet ta ndërrojë emërtimin e tanishëm dhe duhet të jetë: Kushtetuta Kalimtare- një Kushtetutë që do të ketë vlerë deri në definimin e statusit final, kur do të shtrohet çështja e një Kushtetute të re.

Fusha e dytë, që sipas vlerësimit tonë është fusha më e rëndësishme e ndryshimeve, është fusha e cila parasheh ndërrimin e raportit ndërmjet kreut të 5-të dhe të kreut të 8-të, e që nënkupton bartjen e përgjegjësive të reja në këto fusha:

- fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare;
- fusha e rendit dhe sigurisë publike;
- fusha e drejtësisë dhe e sistemit gjyqësor;
- fusha e sistemit të kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë;
- fusha e pushtetit lokal;
- fusha e buxhetit dhe politikës fiskale;
- fusha e energjetikës.

Pjesa e tretë u referohet zgjedhjeve të reja për Kryesinë e Kuvendit – heqja apo rishqyrtimi i sistemit të vendeve të rezervuara, cilësimi i procedurave parlamentare ligjvënëse me qëllim të efikasitetit të këtyre procedurave, si dhe aplikimi i disa zgjedhjeve që mënjanojnë një bllokadë ligjvënëse që shpeshherë është paraqitur, sidomos në relacionet ndërmjet Kuvendit dhe UNMIK-ut – pas miratimit të ligjit.

Pastaj, amendamentet përfshijnë zgjidhje të reja për organizimin e sistemit të gjyqësisë e të prokurorisë dhe në këtë drejtim në kemi bërë amendamente të cilat, që saktësisht e rregullojnë sistemin e gjyqësisë.

Me amendamentet e propozuara i kemi vënë bazat kushtetuese të organizimit të pushtetit vendor, duke krijuar parimet e reformimit të këtij sistemi dhe duke mundësuar organizimin e pushtetit lokal në tri nivele: në nivel të njësive territoriale lokale; në nivel të komunave dhe në nivel të qytetit të Prishtinës.

Një risi e propozuar me amendamente, është institucioni i referendumit - si një mekanizëm vendimmarrës.

Grupi i Punues gjatë tërë kohës ka punuar me konsensus të plotë dhe shumica e zgjidhjeve janë zgjidhje konsensuale. Për disa çështje që janë theksuar në raport ka pasë dallime dhe për to Komisioni ka vendosur t'i japë me alternativa.

Grupi i Punues konsideron se këto ndryshime nuk e cenojnë autoritetin e Rezolutës 1244 të Misionit të Kombeve të Bashkuara, por ato janë një parakusht për vazhdimin e suksesshëm dhe për përmbylljen e sukseshme të këtij misioni.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me propozimin e ndryshimeve dhe të plotësimeve në Kornizën Kushtetuese i dhanë edhe këta deputetë: Fatmir Sejdiu, Bajram Kosumi, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Hilmo Kandiç, Hasn Meta, Smajl Latifaj, Muhamet Kelmendi, Mahir Jakhillar, Xhavit Haliti dhe Sylejman Çerkezi, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi nxori këto

Përfundime:

1. Kuvendi i miratoi në parim propozimet e Grupit të Punës për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese;
2. Ngarkohet Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese t'i shqyrtojë propozimet e Grupit të punës dhe t'ia propozoj Kuvendit amendamentet, në grupe, për miratim.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërtimet - nr.2004/13

Kryetari i informoi deputetët për raportet me rekomandime dhe me amendamentet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit Funksional lidhur me këtë Projektligj.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e prapozuara të Komisionit Funksional dhe të Komisionit të Buxhetit.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56 dhe 57.

Pastaj, kryetari e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----79;

Kundër-----0;

Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin për ndërtimet.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmarrjet- nr.2004/4

Kryetari i informoi deputetët për raportet me rekomandime dhe me amendamentet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit Funksional lidhur me këtë Projektligj.

Bajrush Xhemajli, në emër të Komisionit Funksional, tha se megjithë punën e bërë në Komision gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, që kanë organizuar edhe një dëgjim publikë për të marrë mendimet edhe të ekspertëve jashtë Kuvendit, kemi konsideruar se nuk kemi arritur nivelin e kënaqshëm. Komisioni nuk ka mundur ta ndërrojme konceptin dhe karakterin e Projektligjit. Ne kemi ndërruar aq sa lejohet në këtë fazë të ndërrohet dhe jemi munduar ta bëjmë të zbatueshëm, por nuk jemi të sigurtë se ia kemi arritur. Për t'ia arritur këtij qëllimi, ka qenë dashur që ky Projektligj të rihartohet në tërësi, pra të kthehet që në lëximin e parë, ose nga sponsoruesi të hartohet, ose nga një ekip tjetër. Megjithatë, Komisioni i ka bërë 37 amendamente dhe i kemi përkrahur 8 amendamente të Komisionit për Buxhet.

Bedri Selamni propozoi që në këtë seancë, të mos diskutohet për këtë projektligj, por ai të shtyhet për seancën e radhës ose t'i kthehet sponsoruesit. Ky P/ligj është i gjymt dhe nuk siguron qarkullim të duhur juridik. Të gjitha ligjet për ndërmarrjet apo për shoqëritë tregtare, në shtetet e Unionit Evropian, përmbanjnë prej 570 deri 635 nene, kurse ky i ka vetëm 315.

Nekibe Kelmendi kërkoi nga Komisionit për Buxhet ta qartësojë çështjen e regjistrimit të ndërmarrjeve, pranë cilës ministri ato duhet të regjistrohen?

Fatmir Sejdiu tha se nëse dëshirojmë ta bëjmë një përmirësim të mirë të këtij projektligji, për të cilin ka pasur vërejtje të shumta edhe në shqyrtimin e tij në parim. Atëherë, të mos hapet debati për të. Është i nevojshëm përpunimin i mëtejshëm tij, nëse Komisioni shpreh gatishmërinë, bashkë me të tjerët, ta përgatitë një version tjetër të Projektligjit.

Hydajet Hyseni tha se Kuvendi duhet t'i shqyrtojë amendamentet e propozuara nga komisionet parlamentare dhe pastaj të shihet rezultati. Nëse Kuvendi nuk i miraton amendamentet dhe ligjin, ekziston zgjidhja tjetër, sipas Rregullres së Punës – shqyrtimi i tretë i Projektligjit, nëse e kërkon sponsoruesi. Sponsoruesi mund të paraqesë amendamente të tjera, që mund ta përmirësojnë cilësinë e Projektligjit.

Arsim Bajrami tha se i mbështet vërejtjet e diskutuesve para tij lidhur me këtë projektligj. Ligji për ndërmarrjet është ligj sistemor për transformimin e ekonomisë së Kosovës dhe ligjet sistimore nuk duhet të miratohen shkel e shko. Nëse sponsoruesi i Projektligjit është i mendimit ai duhet të përpunohet, të rishkruhet – atëherë edhe në këtë fazë ekziston mundësia që me kërkesë të sponsoruesit kjo procedurë të ndalet dhe të riaktivizohet pasi ligji të përpunohet.

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi nxori këto

Përfundime:

1. Hiqet nga rendi i ditës shqyrtimi i mëtejshëm i Projektligjit për ndërmarrjet ;
2. Kërkohet nga sponsoruesi ta rihartojë Projektligjin për ndërmarrjet dhe t'ia paraqesë Kuvendit për miratim.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale - 2004/17

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ali Sadria** tha se objektivi i këtij projektligji është vendosja e tatimit në të ardhura personale, në suazat gjithëpërfshirëse, që do të zotohet mbi të gjitha burimet e të ardhurave.

Projektligji është i ndarë në tri pjesë. Pjesa e parë, i referohet tatimpaguesit, shkallës tatimore dhe bazës tatimore. Pjesa e dytë, i trajton rregullat për llogaritjen e të ardhurave të tatimushme nga secili burim. Dhe pjesa e tretë, me të cilën propozohen procedurat administrative lidhur me pagesat dhe formularët tatimor.

Tatimpagues konsiderohen personat fizikë, rezident dhe jorezident, që fitojnë ose marrin të ardhura bruto nga të gjitha burimet e tyre, siç janë pagat, veprimtaritë e biznesit nga qiratë, nga shfrytëzimi i pasurive, pasurisë së patrubzuar, nga interesi, nga dividenda, nga fitimet kapitale, nga fitimi në llogari dhe lojëra tjera të fatit, si dhe çdo burim tjetër që rritë pasurinë neto të tatimpaguesit gjatë periudhës tatimore.

Për secilën periudhë tatimore, tatimi në të ardhura ngarkohet sipas shkallëve tatimore si vijon:

- për të ardhurat e tatueshme vjetore, deri në shumën 960 euro tatimi është 0 euro;
- për të ardhurat e tatueshme vjetore nga 960 euro deri në 3.000 tatimi është 5%;
- kurse për të ardhurat e tatueshme vjetore nga 3.000 deri në 5.400 tatimi është plus 10%;
- ndërkaq për të ardhurat e tatueshme vjetore mbi shumën 5.400 euro tatimi është plus 20%.

Me këtë Projektligj janë të përjashtuar nga pagesa e tatimit të të ardhurave bruto nga pagesat përfaqësive diplomatike ose konsulare, personat e huaj të zyreve të ndërlidhjes në Kosovë. Janë përjashtuar nga pagesa edhe përfaqësuesit zyrtar dhe të të punësuarve të huaj në organizatat qeveritare dhe joqeveritare që kanë statut të përfitimit publik.

Secili punëdhënës është përgjegjës për të mbajtur në burim dhe për të transferuar në buxhetin e Kosovës tatimin mbi të ardhurat personale për të punësuarit e tij

Në pjesën e tretë të këtij Projektligji, janë të përcaktuara procedurat administrative lidhur me pagesën dhe formularët e prezentuar nga administrata tatimore. Të gjithë tatimpaguesit duhet të përgatisin dhe dorëzojnë në një bankë të miratuar nga administrata tatimore një deklaratë tatimore me ose përpara një prilli të vitit që pason periudha tatimore.

Në fund të ekspozitës, ministri Ali Sadriu i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këktij projektligji në parim.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligj i dhanë edhe deputetët: Haki Shatri, Sabri Hamiti, Xhelal Canziba, Bujar Dugolli, Hydajet Hyseni, Alush Gashi dhe Ramadan Kelmendi, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----79;
Kundër-----0;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për tatimin në paga. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi dhe Financa - Komision Raportues- ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandimet për miratim.

6. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për veprimtaritë hoteliere dhe turistike - nr.2004/3

Kryetari i informoi deputetët për raportet me rekomandime dhe me amendamentet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit Funksional lidhur e këtë Projektligj. I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e prpozuara të Komisionit Funksional dhe të Komisionit të Buxhetit.

Kuvendi i miratoi këto amenamente:1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Pastaj, kryetari e hodhi në votë edhe Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----76;
Kundër-----0;
Abstenime---0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi Kosovës, njëzëri e miratoi Ligjin për veprimtaritë hoteliere dhe turistike.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës- nr.2004/16

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, **Hajredin Kuqi** tha se

Komisioni në planin e punës dhe në rekomandimet e tij gjatë vitit të kaluar ka paraparë, përveç tjerash edhe plotësimin e hapësirës legislative në fushën e arsimit dhe të shkencës. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, paraqet një institucion me interes publik e kombëtar për zhvillimin e shkencës, artit dhe të dijes në Kosovë.

Ky Projektligj njeh rolin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës si institucion më i lartë i shkencës dhe artit dhe e parasheh si institucion të themeluar nga Kuvendi i Kosovës. Akademia definohet si person juridik, me autonomi të plotë për përfaqësim të drejtpërdrejtë dhe aftësi juridike në përfaqësim, por edhe në organizimin e saj të brendshëm.

Me dispozitat e veçanta, përcaktohen qartë qëllimet e Akademisë, avancimet e mendimit shkencor dhe krijimtarisë artistike në Kosovë dhe më gjerë, duke dhënë mundësi për organizime kërkimore e shkencore, bashkëpunim të brendshëm dhe ndërkombëtar, publikim të të arriturave të saj, krijimin e njësisve shkencore-artistike, qendrës studimore, bërthamës së studimit e deri te veprimtaria këshilluese edhe për institucionet tona.

Në kreun e tretë, është rregulluar organizimi dhe udhëheqja e Akademisë në pika kryesore, ngase organizimi i hollësishëm është lënë në kompetencë të Akademisë përmes statutit të saj, të cilin do ta nxjerrë Kuvendi i Akademisë.

Si organe të Akademisë janë paraparë: Kuvendi, Kryesia e Akademisë dhe kryetari.

Një fushë e veçantë e trajtimit në Projektligj është bërë edhe lidhur me anëtarët e saj, duke i dhënë të drejtë të plotë Kuvendit të Akademisë që të bëjë përzgjedhjen e tyre sipas kritereve shkencore të propozuara prej saj, e të ngjashme me botën moderne dhe njëkohësisht duke paraparë mundësinë e anëtarësimit si anëtar të rregullt dhe me korrespondencë për shtetasit e vendit dhe duke krijuar mundësinë edhe për anëtar të jashtëm.

Në kreun e pestë, rregullohen detyrat dhe përgjigjësit e sekretarit të Akademisë në organizimin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve teknike dhe profesionale.

Ai, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligj i dhanë edhe deputetët: Sabri Hamiti, Zylfije Hundozi, Gani Sadik, Fetije Këpuska, Blerim Baruti, Sala Ahmetaj dhe Ramadan Kelmendi, që i janë bashkangjitur traskriptit.

Pas këyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Rezultati ishte si vijon:

Për-----78;

Kundër-----0;

Abstenime----0.

Kryetari kostatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, njëzëri, në parim Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Arsim, Shkencë dhe Teknologji – Komision Raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

Kryetari dha pauzë një orëshe.

Pas pauzës seancën e drejtoi **Bajram Kosumi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

8. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për koncesione-nr.2004/19

Kryesuesi e ftoi sponzoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri Bajram Rexhepi: Duke u nisur nga fakti se ngritja e kapaciteteve ekonomike të Kosovës paraqet njërin nga prioritetet në punën tonë të përditshme, Qeveria e Kosovës ia paraqet Kuvendit për miratim Projektligjin për konsesionet. Me këtë Projektligj do të arrihet që disa sfera të rëndësishme të jetës ekonomike, siç është rasti me industrinë minerale dhe atë të transportit rrugor - të krijohen mundësi solide për të pasur një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut të lirë.

Krijohen mundësitë që subjektet kontraktuese në kushte të barabarta të hyjnë në procedurë selektimi sa i përket marrëveshjeve që krijohen lidhur me të drejtën e ushtrimit të veprimtarive ekonomike, shfrytëzimit të pasurive natyrore, të të mirave në përdorim të përgjithshëm dhe ushtrimit të veprimtarive me interes të përgjithshëm.

Me këtë Projektligj bëhet adoptimi i standardeve të Bashkësisë Evropiane të kësaj fushe dhe se i njëjti është plotësisht në pajtim me rregullat dhe parimet numër 34, 52, 59 dhe 67 të Traktatit të Bashkësisë Evropiane.

Projektligji përmban: dispozitat mbi çështjet e përgjithshme, të cilat trajtojnë lëndën e rregullimit; përkufizimet; fushën e zbatimit; qëllimin e dhënies së konsesionit e tjera.

Dispozitat e veçanta, me të cilat rregullohet çështja e themelimit të agjensionit për konsesion, transparenca dhe investimet, forma e konsesionit, autoritetet kompetente për vendosjen e dhënies së konsesionit, të drejtat dhe detyrat e Agjensionit, mënyra e emërimit të anëtarëve të bordit dhe personelit tjetër të agjensionit, mënyra e marrjes së vendimeve, mbikëqyrja dhe kontrolli i punës së agjensionit.

Projektligji rregullon edhe procedurën paraprake dhe kushtet e ofertimit, rregullat mbi veprimet miratuese, hapjen, refuzimin, dhënien dhe përmbajtjen e vendimit.

Projektligji, në mënyrë të veçantë, rregullon çështjet që kanë të bëjnë me subjektet e konsesioneve, përmbajtjen e kontratës, kriteret e caktimit të kompensimit, afatet, regjistrimin, kushtet e ndërprerjes dhe të shkëputjes së kontratës, të drejtat dhe detyrimet e konsesionit, obligimin e pagesës, transferin e konsesionit, mbrojtjen e të drejtave të konsesionarit.

Në fund, kryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë Projektligj.

Kryesuesi e hapi diksutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për koncesionet.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligj i dhanë edhe deputetët: Haki Shatri, Bajrush Xhemajli, Fatmir Rexhepi, Bedri Selmani, Bujar Dugolli, Fetije Këpuska dhe Arsim Bajrami, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votë Projektligjit për koncesionet. Rezultati ishte si vijon:

Për-----62;

Kundër-----4;

Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, më shumicë votash, e miratoi në parim Projektligjin për koncesionet. Kuvendi i ngarkoi komisionet e vecanta dhe Komisionin për Tregt dhe Industri – Komision Raportues- ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veterinarinë - nr.2004/14

Kryesuesi e ftoi sponzoruesi ta arsyetonte Projektligjin për veterinarinë para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri Bajram Rexhepi: Me këtë Projektligj rregullohen këto çështje:

- shërbimi veterinar dhe i ushqimit të Kosovës;
- parandalimi dhe luftimi i sëmundjeve infektive të kafshëve;
- eliminimi dhe pengimi i rrezikut nga përhapja e sëmundjeve epizootike të kafshëve që mbikëqyren nga shërbimi veterinar i ushqimit;
- mbikëqyrja e prodhimeve ushqimore me prejardhje shtazore;
- shpërndarja e prodhimeve ushqimore me prejardhje shtazore dhe ekspertiza veterinare;
- kontrolla veterinare në vendkalimet kufitare dhe në depotë doganore;
- të drejtat dhe obligimet e mjekëve veterinar;
- Oda e veterinarisë së Kosovës;
- të drejtat dhe obligimet e pronarëve të kafshëve;
- zbatimi i këtij ligji me mbikëqyrjen e inspektorëve veterinar; dhe
- masat ndëshkuese për mosrespektimin e dispozitave të këtij ligji.

Gjithashtu, me dispozitat e këtij Projektligji, rregullohen:

- çështja e regjistrimit dhe kategorizimit të prodhimeve ushqimore me origjinë shtazore, të gjithë personat që merren me prodhimin e ushqimit me prejardhje shtazore, tregtimin dhe distribuimin e tyre – duhet të regjistrohen në regjistër të posaçëm të Ministrisë;
- licencimi i personave të cilët mirren me prodhimin dhe vënien në qarkullim të kafshëve dhe produkteve të tyre me origjinë shtazore;
- kontrollimi i prodhimeve me prejardhje shtazore, duke filluar nga procesi i prodhimit, e deri te tregtimi i tyre, me qëllim që të parandalohet paraqitja e sëmundjeve ngjitëse infektive;
- kontrolli veterinar në kalimet kufitare dhe depot doganore;
- masat ndëshkuese, me ç'rast për kundërvajtësit, të cilët me aktivitetin e tyre shkelin dispozitat e këtij Projektligji, janë paraparë dënime tejet të larta.

Me miratimin e këtij Projektligji në Kosovë do të arrihet të sigurohen kushte të domosdoshme ligjore për arritjen dhe ruajtjen e standardeve lidhur me cilësinë e prodhimeve me prejardhje shtazore, si dhe marrja e masave preventive në parandalimin e sëmundjeve ngjitëse infektive të kafshëve, të cilat do ta rrezikonin edhe shëndetin e njerëzve.

N fund, kryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit a miratonin këtë Projektligj.

Kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për veterinarinë.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me Projektligjin për veterinarinë i dhanë edhe deputetët : Tomë Hajdaraj, Berat Luzha, Sebahate Krasniqi dhe Nekobe Kelmendi, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin për veterinarinë. Rezultati ishte si vijon:

Për-----68;
Kundër-----0;
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, njëzëri, në parim Projektligjit për veterinarinë. Kuvendi i garkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Komision Raportues- ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë e brendshme - 2004/18

Kryesuesi e ftoi sponzorusin ta arsyetonte Projektligjin për tregtinë e brendshme para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ali Jakupi: Mungesa e ligjit për tregtinë e brendshme, si dhe ushtrimi i tregtisë sipas ligjeve të miratuara në rrethana dhe kushte të një sistemi ekonomik të kaluar, ka imponuar nevojën e nxjerrjes së ligjit të ri në harmoni me rregullat e funksionimit të ekonomisë në kushte të tregut të lirë.

Tregtia, një sektor i rëndësishëm ekonomik, ka shtrirje të gjerë dhe aktualisht është veprimtari dominante në Kosovë. Pikërisht nga ky shkak konsiderohet nevojë e drejtpërdrejtë për ligj adekuat, me të cilin përcaktohen aktivitetet për tregtinë e brendshme në kushte konkurruese për të kënaqur nevojat e konsumatorëve dhe për të realizuar profit për ndërmarrësit.

Objektivi i këtij projektligji është ofrimi i barabart i kushteve, mënyra dhe detyrat e njëjta të subjekteve që përcaktohen të ushtrojnë veprimtarinë tregtare.

Projektligji është i ndarë në katër pjesë dhe në 49 nene.

Në pjesën e parë, përfshihen dispozitat e përgjithshme.

Në pjesën e dytë, përcaktohen nocionet e tregtisë së përgjithshme, në përgjithësi të tregtisë me shumicë, të tregtisë me pakicë, të aukcioneve, të ndërmjetësuesve në tregti, ku

në veçanti dallohen distribuimi ekskluziv, distribuimi selektiv, franshizingu, shitja në distancë ose nga largësia, shitja personale derë me derë.

Në pjesën e tretë, sanksionohen kushtet që kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarive tregtare. Këtu përfshihen kushtet minimale teknike që duhet t'i plotësojnë shitoret, depotë e kapacitetet tjera

Në saje të këtyre kushteve, përcaktohet mundësia e dhënies së lejes për punë. Njëkohësisht vëhen në pah kufizimet e përkohshme që dalin nga Qeveria në rastet e fatkeqësive natyrore dhe elementare, kur ndodh ndonjë çrregullim i konsiderueshëm në tregun e brendshëm për shkak të gjendjes së luftës, ose rrezikut nga lufta, si dhe të sigurimit të prodhimit me material riprodhues me rëndësi strategjike.

Pjesa e katërtë, përmban dispozitat e mbikëqyrjes dhe të masave administrative, që kanë të bëjnë me implementimin e dispozitave të këtij ligji, funksion që ushtrohet nga inspeksioni i tregtisë.

Projektligji përmbillet me dispozita ndëshkuese dhe ato përfundimtare.

Në fund, ministri Ali Jakupi to i eputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për tregtinë e brendshme.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me Projektligjit për tregtinë e brendshme i dhanë edhe deputetët: Bajrush Xhemajli, Sebahate Krasniqi dhe Gani Prekopuca, që i janë bashkangjtur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin për tregtinë e brendshme. Rezultati ishte si vijon:

Për-----68;
Kundër-----0;
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri, e mratoi në parim, Projektligjit për tregtinë e brendshme. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Tregti dhe Industri - Komision Raportues- ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gatishmërinë emergjente civile -nr. 2004/15

Kryesuesi e ftoi sponzoruesin ta arsyetonte Projektligjin për gatishmërinë emergjente civile para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Jakup Krasniqi : Nevoja për nxjerrjen e ligjit për gatishmërinë emergjente civile në Kosovë, është i një rëndësie mjaft të madhe, sepse Kosovës i mungon legjislacioni i përshtatshëm i cili i referohet çështjes së gatishmërisë emergjente civile.

Synimi i këtij Projektligji është zbatimi i rregulores së UNMIK-ut 2001/19 për Kornizën Kushtetuese me të cilën përcaktohen përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë. Me të u jepet institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes kompetenca të kësaj fushe me sa vijon:

- zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë për planifikimin e rasteve emergjente dhe të mbrojtjes civile;
- drejtimin dhe koordinimin e shërbimeve të zjarrfikjes dhe shpëtimit në bashkëpunim të ngushtë me komunat.

Roli kryesor i Projektligjit është në përcaktimin e përgjegjësive për të gjitha subjektet që do të merren me gatishmërinë emergjente civile.

Projektligji për gatishmërinë emergjente civile në Kosovë përbëhet prej tetë kapitujve dhe 16 neneve.

Kapitulli i parë, përfshinë përkufizimet që përdoren në ligj, të cilat ndihmojnë në kuptimin më të mirë dhe më të plotë të ligjit, interpretimin dhe aplikimin e tij në praktikë.

Në kapitullin e dytë, janë përcaktuar përgjegjësitë qeveritare për gatishmërinë civile.

Në kapitullin e tretë, janë përcaktuar përgjegjësitë e Ministrisë për gatishmërinë dhe reagimet emergjente në Bordin këshillues të shërbimeve emergjente.

Në kapitullin e katërtë, janë përcaktuar përgjegjësitë e komunave për gatishmërinë emergjente civile.

Kapitulli i pestë, janë rregulluar shërbimet komunale, pjesëmarrjen e TMK, të policisë së UNMIK-ut, të SHPK-së, si dhe shfrytëzimin e resurseve të KFOR-it.

Në kapitullin e gjashtë, është përcaktuar reagimi emergjent, aktivizimi dhe komanda operacionale e shërbimeve emergjente, si dhe detyrat e individëve gjatë emergjencave.

Në kapitullin e shtatë, është përcaktuar preventiva ndaj zjarrit, përgjegjësitë e komunës për preventivë, si dhe përgjegjësitë individuale dhe të kompanive në gatishmërinë emergjente civile dhe preventivë ndaj zjarrit.

Në kapitullin e tetë, janë përcaktuar dispozitat përfundimtare për zbatimin e ligjit, si dhe hyrja e tij në fuqi.

Projektligji i jep Ministrisë së Shërbimeve Publike instrumentin ligjor për të reaguar në mënyrë efikase dhe efektive në krizat eventuale dhe për të siguruar vendosjen e masave preventive.

Projektligji rregullon koordinimin e veprimeve të Ministrisë së Shërbimeve Publike me Ministrinë e Shërbimeve të Shëndetësisë, me Ministrinë e Mjedisit, me Ministrinë e Transportit, me Shërbimin Policor të Kosovës dhe me Trupat e Mbrojtjes së Kosovës.

Në fund, ministri Jakup Krasniqi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për gatishmërinë emergjente civile.

Agim Krasniqi, në emër të Komisionit parlamentar për Gatishmëri Emergjente, i paraqiti disa vërejtje në kët projektligj.

Vërejtja kryesore është se emërtimi i këtij Projektligji nuk është në përputhshmëri dhe në pajtim me dispozitat e Kornizës kushtetuese.

Koncepti i mbrojtjes civile përmendet vetëm në sqarime, ndërkaq në përmbajtje të Projektligjit nuk përmendet askund.

Ai i paraqiti disa vërejtje dhe propozime lidhur me këtë projektligj, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Naim Maloku i bëri një vështrim transformimit të Departamentit për Gatishmërisë Emergjente. Ai në fillim ka qenë i themeluar si Departament për Siguri Civile dhe Emergjencë, nën kompetencat e Shtyllës së Parë të UNMIK-ut, dhe pastaj ka kaluar në kompetenca të Shtyllës së Dytë, por me emër tjetër – Departamenti për Gatishmëri Emergjente Civile, kurse tani, ai është në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Ne sot po e shqyrtojmë Projektligjin, i cili e rregulon fushëveprimin dhe kompetencat që i ka ky departament pranë kësaj Ministrie. Pra, nuk është Projektligji për Mbrojtje Civile, por Projektligji për Gatishmëri Emergjente Civile.

Ai, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, i paraqiti disa vërejtje në nenet: 3, 4.2, dhe 6.6c, të këtij projektligji, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah miratimin e këtij projektligji në parim.

Sabile Keçmezi – Basha tha se Projektligji për gatishmërinë emergjente civile në Kosovës është njëri ndër projektligjet që është i përgatitur mirë.

Është për t'u përhëndetur një qasje e re e paraqitjes së Projektligjit, me anën e së cilës bëhet prezentimi i shkurtër i kapitujve që në fillim të tij. Inisiativa që e ka aplikuar Ministria për Shërbime Publike gjatë hartimit të këtij Projektligji, i cili është prezentuar dhe diskutuar edhe në takimet me administratat regjionale e komunale në mbarë Kosovën dhe ka pasur një dëgjim publik dhe e tërë kjo ka qenë shumë e suksesshme.

Ajo i paraqiti disa vërejtje në nenet: 1, 2.2, 4, 5.4, 9.1, 11a, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah miratimin e këtij projektligji në parim.

Halil Ahmeti tha se Projektligji për gatishmërinë emergjente civile ka shumë mangësi.

E para, Qeverisë së Kosovës i mungojnë dy ministri përkatëse: Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit. Dhe, në mungesë të tyre, gjatë hartimit të Projektligjit janë ngatërruar shumë çështje në fusha të mbrojtjes civile dhe të gatishmërisë emergjente.

E dyta, duhet t'i ndërrohet emri këtij projektligji dhe të jetë: Projektligji i mbrojtjes civile dhe gatishmërisë emergjente

Ai nuk e përkrahu miratimin e këtij projektligji në parim.

Ramadan Kelmendi i paraqiti disa vërejtje në këtë projektligj, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Ai shtoi se ky projektligj duhet të kthehet në rihartim.

Gani Koci tha se duke e ditur sot pozicionin e Departamentit për Gatishmëri Emergjente Civile, funksionet dhe kompetencat që i ka, nuk ka mund të bëhej një ligj me ato dëshira, funksionet dhe me ato kompetencat, që do t'kishte edhe ky Departament.

E kuptoj dëshirën e të gjithëve që vërtet të kemi një ligj për Mbrojtjen Civile, një ligj për Mbrojtjen Territoriale, një ligj për Armatën. Por, tani është një formë e re e organizimit dhe e veprimtimit edhe në këto fusha.

Ministri Jakup Krasniqi iu përgjigj vëretjeve të deputetëve lidhur me projektligjin për gatishmërinë emergjente civile.

Në fund, **kryesuesi** e hodhi në votë Projektligjin për gatishmërinë emergjente civile. Rezultati ishte si vijon:

Për-----34;

Kundër-----36.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, nuk e miratoi Projektligjin për gatishmërinë emergjente civile.

Kryesuesi e deklaroi seancën të mbyllur në orën 16: 35 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik Nexhat DACI